



Datë: 27.05.2025
Numër Protokolli: 3545/2025

A.nr.735/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.735/2025, të datës 25.04.2025, të parashtruar nga ankuesja R.S-J., kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.735/2025, e datës 25.04.2025, e parashtruar nga ankuesja R.S-J.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile R.S-J. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), fizikisht më datë 25.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-358/25 të datës 18.03.2025 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin nga pozita Zyrtar i Lartë për Siguri Rrugore në pozitën Zyrtar i Lartë për Licencime, ndërsa ankuesja më datë 27.05.2025 është tërhequr nga ankesa me numër protokolli 2763/2025.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.735/2025 të datës 25.04.2025.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.735/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses R.S-J.;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI;
- Drejtorit të DMZP ne Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.